



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Integritime Evropiane

Mbledhja nr. 49

Prishtinë, më 16. 02. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane**

**Në mbledhje morën pjesë:** Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emiri, Nait Hasani dhe Naser Rugova.

**Mungoi:** Mursel Halili.

**Nga Staf i Mbështetës i Komisionit:** Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

**Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi** - kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve më 18. 01. 2010 dhe 25. 01. 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës nr. 03/L-171 me amendamentet e Komisionit Funkcional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE – së,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Hetimin Parlamentar me amendamentet e Komisionit Funkcional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me amendamentet e Komisionit Funkcional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së,
6. Të ndryshme.

**Kryesuesja** konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

#### **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve më 18. 01. 2010 dhe 25. 01. 2010.**

*Procesverbalet e mbledhjeve më 18. 01. 2010 dhe 25. 02. 2010 u miratuan pa vërejtje.*

#### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës nr. 03/L-171 me amendamentet e Komisionit Funkcional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së.**

**Kryesuesja** – E ftoi deputeten Njomza Emini, referuese e këtij projektligji, ta paraqesë Raportin për këtë projektligj.

**Njomza Emini** - Tha se ky projektligj mund të procedohet më tutje, sepse kjo fushë nuk rregullohet me legjislacionin e BE - së.

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

#### ***Përfundim***

***Projektligji për Mërgatën e Kosovës nr. 03/L-171, me amendamentet e Komisionit Funkcional, rregullohet me legjislacionin nacional.***

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për Hetimin Parlamentar me amendamentet e Komisionit Funkcional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së**

**Kryesuesja**, referuese e këtij projektligji paraqiti Raportin për këtë projektligj.

**Kryesuesja** - Tha se ky projektligj mund të procedohet më tutje, sepse kjo fushë nuk rregullohet me legjislacionin e BE - së.

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

#### ***Përfundim***

***Projektligji për Hetimin Parlamentar me amendamentet e Komisionit Funkcional, rregullohet me legjislacionin nacional.***

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me amendamentet e Komisionit Funkcional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së**

**Kryesuesja** – E ftoi deputeten Edita Tahiri, referuese e këtij projektligji, ta paraqesë Raportin për këtë projektligj.

**Edita Tahiri** - Tha se ky projektligj mund të procedohet më tutje, sepse ky ligj nuk i cenon parimet e acquis komunitare.

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

## ***Përfundim***

***Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale me amendamentet e Komisionit funksional, është në harmoni me acquin komunitare.***

### **6. Të ndryshme.**

#### **a) Dinamika e punës së Komisionit**

**Edita Tahiri** deshi të dijë për dinamikën e zhvillimit të punës së Komisionit dhe përkrahjes për zhvillimin e aktiviteteve të tij.

**Kryesuesja** – I njoftoi se seminari i organizuar nga TAIEX - i do të mbahet në fund të muajit shkurt. OSBE - ja do të organizojë dy udhëtime, në mënyrë që të realizohet kërkesa e një pjese të diplomacisë parlamentare të Komisionit, njëra në Estoni e tjetra në Çeki. Po ashtu me përkrahjen e TAIEX - it do të realizohet një vizitë në Bullgari. Sa i përket vizitës në Spanjë tha se kemi biseduar me drejtoreshën Ebert Schiftungut, për të parë mundësinë e realizimit të asaj vizite dhe po presim njoftimin nga ana e saj. Lidhur me Planin e Veprimit tha se deri më tani nuk kam caktuar mbledhje, duke pritur se do të miratohet edhe në seancë plenare, mirëpo tani do të fillojmë të punojmë ne, si Komision, për ato çështje që janë në kompetencën tonë.

**Mbledhja përfundoi në orën 11: 30 min.**

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisioneve**

**Kryetare e Komisionit**

---

**Zylfije Hundozi**